



**BASHKIA  
TIRANË**



**NATIONAL  
YOUTH  
CONGRESS**

**AUF**



Jemi të lumtur të njoftojmë se, në thirrjet direkte për projekt ide që Bashkia e Tiranës hapi në kuadër të shpalljes “Tirana Kryeqyteti i të Rinjve Europianë” **Klubi studentor i Artit dhe i Muzikës i Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës, në bashkëpunim me Agjencinë Universitare të Frankofonisë (AUF) ka fituar projektin:**

## **“Festivali i të Rinjve të Ballkanit Perëndimor”**



Qyteti i Tiranës, në një vrull të plotë kulturor, do të mbledhë për një javë të rinj frankofonë nga i gjithë rajoni i Ballkanit Perëndimor.

Ne duam të krijojmë një hapësirë për shkëmbime mes të rinjve në një atmosferë miqësore duke përdorur gjuhën frënge si mjet komunikimi.

Një gamë e gjerë aktiviteteve do t'u ofrohet pjesëmarrësve mbi tematikat e dialogut ndërkulturor dhe bashkëpunimit rajonal, duke filluar nga organizimi i atelieve për krijimin e afishave të dialogut ndërkulturor, tek realizimi i videove të mesazheve të paqes në rajon dhe aktiviteteve kulturore.

Gjithçka do të përfundojë me stil me një mbrëmje gala që bashkon talentet dhe energjitë e të rinjve frëngjishtfolës.